REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 359
Datë/Datum. 10. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Ekstrakt nga procesverbali nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 30.06.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Etnik Berjani, Burim Berisha, Ali Topalli, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërrnava, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Gjelbrim Halili dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Aida Alimi.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Shpend Bardiqi - Nënkryetar i Komunës, Bardhyl Koiçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Albana Gashi - Drejtoresha për Shëndetësi, Adriatik Zeqiri – Drejtor i Arsimit, Pranvera Merovci - Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 26.05.2026.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.
4. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026.
5. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.
6. Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë – Kosovës për vitin 2026.
7. Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi post mortum", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026.
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
10. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës.
11. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të Komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

12. Propozim për shqyrtim dhe dhëniën e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi.
13. Propozim për plotësimin e vendimit në përfshirjen e drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.
14. Të ndryshme. H

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar të pranishëm, i nderuar z. Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, të nderuar drejtor nga ekzekutivi, të nderuar asambleistë ju falenderojë për pjesëmarrjen në mbledhjen e gjashtë të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës. Dua të ju njoftoj që për shkak të një aktiviteti të drejtorisë së bujqesisë ka ndodhë një lëshim teknik dhe mikrofonët janë jashtë funksionit andaj ju lutem që kur te flisni ta ngritni zërin. Po e hapi zyrtarisht mbledhjen e gjashtë të Kuvendit të komunës së Fushë Kosovës, materialin dhe pikat e rendit të ditës i keni pranuar me koh, i keni fizikisht para jush së bashku me rekomandimet që kanë dalur nga Komiteti për Politikë dhe Financa, po filloj me leximin e tyre: Pika e parë e rendit të ditës është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 26.05.2026; Pika e dytë është Pyetje dhe përgjigje parlamentare; Pika e tretë Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029; Pika e katërt është Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026; Pika e pestë është Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese; Pika e gjashtë është Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026; Pika e shtatë është Propozim për shpalljen e titullit " Qytetar nderi post mortum", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026; Pika e tetë është Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale, Pika e nentë është Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike; Pika e dhjetë është Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës; Pika e njëmbëdhjetë është Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të Komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës dhe Pika e dymbëdhjetë është Të ndryshme: kemi edhe dy rekomandime nga Komiteti për Politikë dhe Financa, është Propozimi që ka ardhur për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës për ndihmë financiare për shërim dhe pika tjetër është Propozimi për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029. Po e hapi diskutimin për Pikat e rendit të ditës dhe dy rekomandimet që kanë ardhur nga Komiteti për Politikë dhe Financa, Lëvizja Vetëvendosje fjala për ju.
Kosovar Ademi: Pajtohemi me rendin e ditës dhe pikat shtesë.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, Lidhja Demokratike e Kosovës?
Laureat Gojnovci: Pajtohemi.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, Partia Demokratike e Kosovës?
Migjen Kolshi: Pajtohemi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë po e qesim në votim propozimin për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës propozimin për ndihmë financiare për shërim, Kush është PËR?
U votua Unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë (29) anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se hyn ky propozim si pikë e rendit të ditës dhe tjetra është për përfshirjen e drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029, Kush është PËR?
U votua Unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë (29) anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se hyn ky propozim si pikë e rendit të ditës. Tani po e qesim në tërësi rendin e ditës së bashku me dy rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Kush është PËR?
U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë (29) anëtarë. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se u votua rendi i ditës me dy rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 26.05.2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, Aprovimin e Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës te datës 26.05.2026, e hapi diskutimin Lëvizja Vetëvendosje fjala për ju.
Kosovar Ademi: Pajtohemi me përmbajtjen e ekstraktit.
Laureat Gojnovci: Ne si grup parlamentar nuk e përkrahim këtë procesverbal.
Migjen Kolshi: Nuk e përkrahim këtë procesverbal.
Ali Ismaili: I nderuar kryesues, kryetar dhe ju kolegë i kam vërejtjet e mia sa i përket ekstraktit të procesverbalit. Vërejtja e parë që e kam është kur vijmë me marrë materialin nuk po arrijmë ta marrim të kompletuar, rregulloret nuk përfshihen në material dhe as ekstrakti, neve na thuhet që do të na vie në email por nuk ka mundësi të printohet nga aty, duhet ta lexojmë përmes telefonit ose laptopit. Nga telefoni e kam lexuar ekstraktin e procesverbalit dhe kërkoj nga sekretariati i Kuvendit ti kthehet incezimit dhe mos të na nxerr prej tekstit të cilin e kemi shfaqur këtu gjatë debatit. Kërkoj gjithashtu që të bëhet rregullimi i mikrofonëve të sallës, te rregullohet ekstrakti i procesverbalit dhe të na pajiseni me atë ekstrakt. Faleminderit.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Ali, kërkesa juaj është me vend dhe do të merret parasysh, meqenëse nuk kemi diskutime tjera po e qesim në votim kush është PËR?
U votua me shtatëmbëdhjetë vota "Për" asnjë votë "Kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje gjithsej tridhjetë anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u votua "Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datë 26.05.2026" me përmirësimet e cekura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani fjala është për ju asambleistë.
Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, i nderuar Kryetar, anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtor prezentë dhe ju të pranishëm. Kam disa çështje që dua ti ngrisë në këtë kuvend, kam një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë e cila ka nxjerrë një vendim për ndërprerjen e lëshimit të certifikatave të punësimit të cilat janë nxjerrë më parë në QKMF, është thirrë në një udhëzim administrativ i cili është 03/2024, ky udhëzim e rregullon çështjen e pagesave brenda QKMF-së, është dashur të thirret në ofrimin e shërbimeve në QKMF, në udhëzimin administrativ 04/2013, ky udhëzim rregullon se cilat shërbime ipen në QKMF. Me këtë vendim cënohen familjet e dëshmorëve, invalidëve te luftës e veteranëve të cilët nuk kanë pasur nevojë të paguajnë në QKMF për certifikatën e punësimit, dhe tash të gjithë qytetarët detyrohen të shkojnë të nxjerrin atë certifikatë në ordinance private. Ju bej thirrje ta shfuqizoni këtë vendim. Kryetar në QKMF nuk bëhet analiza e hemogramit për shkak të mungesës së materialit e cila është analizë jetike ju lutem na tregoni arsyejen dhe kur pritet të rregullohet kjo çështje? Çështja tjetër ka të bëj me tenderët në Komunën e Fushë Kosovës, po ju drejtohem drejtorit të shërbimeve publike dhe Kryetarit të komunës të cilet e kanë bërë një tender me një kompani private në vlerë prej 150,000.00€, dhe ky tender është me negocim, a mund të na tregoni se a është kompani private ajo që po mbeldhë mbeturinat sepse qytetarët po paguajnë për këtë shërbim te kompania Pastrimi, dhe komuna po paguan për të njëjtin shërbim një kompani tjetër? Po ashtu tenderi në vlerë prej 710.000.00€, për blerjen e paisjeve ka pasur kërkesa të çuditshme të cilat i përshtaten veç nje kompanie, mbasi është shpallë tenderi ditën e nesërme janë ndërruar referencat, gjithashtu te tenderët në rrugen "Pajazit Islami" në vlerë 650.000.00€, i keni qitë 38 kërkesa për me i poseduar paisjet për ta fituar atë projekt. Pyetja tjetër Kryetar është veturat zyrtare, a u ke lejuar drejtorëve ti përdorin jashtë orarit të punës? Pse është anuluar thirrja për subvencione në DKRS dhe pse nuk është publikuar anulimi i kësaj thirrje? E kam nje pyetje për drejtoreshën e administratës dhe kryetarin për udhëtimet zyrtare në të cilat po shpenzohet shumë dhe kam parë një kontratë të Kryetarit që e kishte bere kornizë për bileta të avionit, pse duhet të udhëtohet jashtë Shqiperisë ose Maqedonise kur ne nuk jemi nivel qendror. Ju faleminderit për durimin.
Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë, Pyetja e parë ka të bëj me drejtorin e shërbimeve publike, është bërë publike nëpër media se kompania e cila ka fituar tenderin punon me katër kamionë ndërsa realisht punon me tre kamionë pse po jepni këso informata jo të sakta? Pyetja tjetër drejtor duke pasur parasysh problemin e Fushë Kosovës me mbeturina a ka pasur persona brenda kompanisë Pastrimi të cilet e kanë bojkotuar punën dhe i kanë prishur kamionat me qëllim, një punëtor i kompanisë Pastrimi i ka hudhë mbeturinat në oborrin e Komunës dhe ai person ishte nga ana e pushtetit. Pyetja për drejtorin e bujqesisë, para disa ditëve ka filluar dezinfektimi i hapësirave publike dhe mbas dy ditëve janë shfaqur insektet do të thotë se ai dezinfektim nuk ka pasur asnjë efekt? Pyetja për Drejtorin e Kulturës; Çka është duke ndodhur me stadionin e qytetit pse nuk kanë filluar punimet? Te tenderi për kamiona e keni planifikuar shumë mirë kriteret për shokët e juaj. Pyetje për Drejtorin e Arsimit, në shumicën e shkollave ke mbi 1000 nxënës, konkretisht te aneksi 1, një psikologes ju ka ndërpre kontrata e punës, pse nuk ju ka vazhduar

kontrata kur shkolla ka nevojë të madhe për të? Deshta ti uroj kryesuesit për emërimin e bashkëvendasit të tij Ekrem Berjani, si drejtor i ndërrmarrjes publike lokale, nuk kam asnjë problem me z.Berjani, por Lëvizja Vetëvendosje ka bërë padi ndaj tij për keqperdorim gjatë kohës kur ai ka qenë drejtor i pushtetit të kaluar dhe mendoj që më s keni kredibilitet ta kritikoni qeverisjen e kaluar. Faleminderit.

Ali Ismaili: I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, nënkryetar, e kam një pyetje nga qytëtarët; Çka duhet të bëjmë pas angazhimit të kësaj kompanie private në raport me pagesat për mbeturina; Një pyetje tjetër nga qytetarët:Thonë a ka mundësi të vendosen dy zebra te kryqëzimi tek shkolla Daut Bogujevci, dhe te gjykata. Për Drejtorin e Arsimit me çfarë vendimi i keni obliguar nxënësit e shkollës fillore që të marrin pjesë në një kamping 2 ditor dhe në të njëtën kohë i keni dërguar për vizitë në Ujman? Një qytetar tjetër pyet për Rr. "Tahir Zemaj" kur planifikoni që të fillojnë punimet në këtë rrugë? Unë i kam përgaditur disa pyetje si herën e kaluar dhe do të ia jap Kryesuesit, tash e tutje do ti publikoj edhe në kanalet e mia. Faleminderit.

Radoman Doderovic: Përshëndetje për të gjithë, e kemi një problem në fshatin Kuzmin, ka vetëm dy orë ujë të pijes, në mëngjes një orë dhe më vonë një orë, gjithashtu është dhe problemi i mbeturinave, kërkoj nga ekzekutivi që të reagojnë ose të bllokojnë rrugën derisa të kryhet ky proces. Faleminderit.

Ali Topalli: Përshëndetje të nderuar këshilltarë Komunal, Kryesues, i nderuar Kryetar, Nënkryetar. Dua të di në çfarë baze ligjore është bërë anulimi i thirrjes për subvencione në drejtorinë për kulturë, rini dhe sport? Drejtori i kulturës na ka thënë se punimet e stadiumit,sipas kryetarit të federatës së futbollit i cili na ka dërguar email zyrtare, që nuk e vazhdojmë këtë projekt, kam kontaktuar me Kryetarin dhe ai ka thënë se nuk ka dërguar email, pavarsisht se kemi mjete të ndara dhe janë të dedikuara për vazhdimin e punimeve për këtë vit. Kryesues dua të ju përgëzoj për vizitën në Shqipëri, dhe deshta të ju pyes sa punëtor i keni në zyrën e kuvendit? Faleminderit.

Vjosa Kida Hyseni: Përshëndetje për të gjithë, çfarë është duke ndërmarrë Inspeksioni sa i përket rrugës "Dardania", në këtë kohë që është duke u punuar. Pyetja e dytë është për rrugën "17 Shkurti", trotuari është gjithmonë i zënë prej taksive private dhe qytetarët kanë probleme të lëvizin dhe të njëjtën kohë dhe makinat kanë problem të qarkullojnë shkaku që është e zënë gjithmonë?

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje Kryetar, Kryesues, drejtora të drejtorive i kam disa pyetje: Pse nuk ju është vazhduar kontrata me Kosova Med disa punëtorëve në Qendërën për Punë Sociale dhe psikologëve nëpër shkolla, e disave po? Për drejtoreshën e administratës sa është numri i punëtorëve në komunë përfshirë dhe ata me projekte? Prapë pyetje për drejtoreshën, në debate televizive prioritet e ke pasur shkollën aneksi 3, pse në buxhet ske paraparë asnjë cent për atë shkollë? Veturat zyrtare a janë vetëm për drejtor apo dhe për nipa e mbesa që shkojnë në Sllatinë te Viva Fresh dhe marin gjëra ushqimore? Pytje për kryetarin çka po ndodhë me palestrën e sportit në Sllatinë, pse nuk po lëshohet dhe a ka mirëmbajtje? Për kontratat njëburimore qeverisja e Burim Berishës, kurrë nuk ka pas? Dhe për Drejtorin e Infrastrukturës dhe për Drejtorin e arsimit bashkarisht, te Al Trade e ke komplet me zhavor rrugën, tani mbasi fëmijët janë në pushim a do të rregullohet kjo rrugë?

Valon Murseli: Përshëndetje Kryesues, Kryetar dhe ju të pranishëm, pyetje për kryetarin dhe drejtorin e shërbimeve publike pse është dashur të shkohet në formë të negocimit për kontratën për mbledhjen e mbeturinave kur ky problem nuk është sot, një dokument që është në E - prokurim, janë tri kompani që janë interesuar për këtë kontratë dhe janë vlera që janë negociuar nga vlera 80€ për m3 deri me 23.5€ për m3 që është vlera më e vogël dhe është negociuar me këtë kompani me vlerë 150.000.00€ në afat prej 6 muajsh, nuk jemi kundër zgjidhjes së problemit me mbeturina por vetëm pse nuk është bërë më konkurenc të lirë. Po ashtu për tenderin për furnizim me paisje, janë shkurtuar afatet për aplikim në 20 ditë ndersa sipas ligjit për prokurim duhet të jenë së paku 40 ditë, për shkak se është tender i madh, nga të gjitha kërkesat kanë mbetur vetëm dy operator në garë. Po ashtu sipas njoftimit të bordit me datë 26.06.2026, është bërë përfundimtare lista e zgjedhjes së kryeshefit të ndërmarrjes publike lokale ku për çudi është daja juaj Ekrem Berjani. Një pyetje për drejtoreshën e shëndetesisë mbi cilen bazë ligjore jeni thirrë kur keni kërkuar që vendimin që e kemi votuar të gjithë për mbështetje financiare për personat me autizëm dhe sindromin doën të jenë banorë, në tri vitet e fundit të Fushë Kosovës? Pyetje për drejtorëshën e zhvillimit ekonomik, e kemi parë një thirrje për start-up, a është bërë e mundur që ky aplikim të bëhet online përmes E – Kosovës ose forma tjera, ose dokumentet të vendosen në CD për shkak të transparencës. Pyetje për Drejtorin e arsimit përdorimi i substancave narkotike është berë dukuri nëpër shkolla dhe duhet, drejtori i arsimit së bashku me institucionet e sigurisë të merret më këtë çështje, po ashtu çerdhja e re e cila është përuruar në fund të vitit të kaluar a është gati për këtë vit shkollor, dhe çerdhja që është duke u punuar në rrugën "Shukrje Obërtinca", kur pritet të jetë e gatshme? Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit është bërë vendimi për forminin e një komisioni për trajtim të veçantë për ndërtesat ekzistuese ose legalizimin, sa kërkesa janë legalizuar dhe çka po ndodhë me këtë vendim? Për drejtorin e urbanizmit dhe inspeksionit nga ndertimet e reja që janë duke u rregulluar te pjesa kundër zjarrit sa janë duke u respektuar rregullat? Pyetje për drejtorin e inspektoriatit pse komuna nuk ka kompani të kontraktuar për autobartje? Për Drejtorin e Infrastrukturës, në projektin për rregullimin e shëtitores në rrugën "Hajrullah Zymi", ka qenë dhe ndriçimi publik, i cili është vendos paraprakisht, pastaj është tërheqë, kërkojmë që të vendoset prapë. Është premtuar shumë transparenc, ka dy muaj që kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare për automjete për periudhën janar – prill, kanë qenë të informuar Kryetari dhe zyrtari përmes emailit, këtë kërkesë e kam dërguar përmes Agjensionit për Informim, për çka pres të marrë përgjigje. Faleminderit.

Rrahim Tërnava: Deshta ti them drejtorit të Shërbimeve Publike që të merret më shumë me rrugën "Ymer Sfarqa", sepse është problem mbi 30 vite. Kërkesa e Migjenit ishtë shumë serioze kerkoj nga ju Kryesues dhe Kryetar të bëhet një komision hetimor, dhe Migjeni të zgjedhet kryesues i komisionit dhe së bashku me eksperta të dalë të hulumtoj si e ka bërë ajo kompani dezinfektimin, a ka përdorë preparatë adekuatë apo jo, sepse është kontratë e trashëguar dhe nëse nuk e ka kryer punën si duhet këtë here, atëherë asnjëherë nuk e paska kryer si duhet, dhe për këtë të merren organet e drejtësisë më të. Drejtori i kulturës, duhet të merret më shumë me sport sepse sporti ne Fushë Kosovë është në gjendje shumë të keqe, duhet të bëhet zgjidhje sa më e shpejtë, kjo është kërkesa ime.

Etnik Berjani: Përshëndetje për të gjithë, Kryesues a mundesh me na tregu datën kur funksializohen mikrofonët? Rruga "Dorentina" rreth hekurudhës arsyeja pse është ndaluar, kam marrë informata nga zyrtarët e Ministrisë së Infrastruktrurës që është bërë për një pagesë të një projekti 3000€, nuk është duke vazhduar? Te tenderi i kamionëve për pastrim pse janë anashkaluar fshatrat, kushë fshihet pas asaj kompanie, e ka marrë tenderin dhe në emër të kujt janë kamionët? Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Konstatojë se kanë përfunduar pyetje parlamentare, vazhdojmë me përgjigjet.

Kryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, tema kryesore e pyetjeve ishte problemi me mbeturina, tenderi në vlerë 150,000.00€, tenderi me kamionë. Pyetja që bëri Etniku, pse jo në fshatra, jemi dakorduar bashkarisht me KRM "Pastrimi", me Jetmirin e kemi marrë përsipër zgjidhjen e ketij problemi përkohësisht, e kemi angazhuar një kompani private për qytet sepse KRM "Pastrimi", është zotuar që në fshatra mundet ta kryej punën. Për asambleistin Valon, kanë aplikuar disa kompani me çmime të ndryshme, drejtori ka arritur ta marrë vlerën 25€ për ton, 150,000.00€ janë të ndara por nuk besoj që do të hargjohen sepse Fushë Kosova, nuk ka aq sasi të madhe të mbeturinave, kompania është kontraktuar për shkak se gjendja me mbeturina është e rëndë. Projekti i KFV-së, për 100 kamionë është në dorë të Fushë Kosovës, për hir të donacionit ne kemi tentuar të bëjmë zgjidhje për të mos humbur 72,000,000.00€, dhe nëse ndahemi do ta bëjmë ndarjen e tillë që të mos humbet donacioni. U përmenden veturat zyrtare jashtë orarit të punës, ka drejtora të caktuar që e kanë të drejtën ti shfrytëzojnë jashtë orarit të punës veturat për punë zyrtare. Sa i përket thirrjes publike të DKRS-së, ish-kolegu yt Ali, Fatlumi është mësuar ti bëj vendimet si në të kaluarën mirepo te unë ajo nuk ecën, u fol edhe për stadium, keni thënë që e keni bërë stadiumin me financim të federatës mirepo nuk është e vërtetë sepse federata nuk financon stadiume. Shtëpinë e Kulturës e keni lënë në gjendje të mjerueshme. Valon, ka telashe sa i përket procesit të legalizimeve, disa kompani kanë falimentuar, drejtori ju ka dhënë udhëzime qytetarëve si të vazhdojnë me procedurë, disa qytetarë kanë bërë padi ndaj kompanive, legalizimi bëhet si procesi përbashkët i një hyrje. Për autobarje; është një kontratë e cila ka shumë telashe dhe ne nuk e vazhdojmë atë kontratë, po besoj qe kjo duhet të vazhdojë me polici ndërsa komuna të jap pëlqime, leje për të punuar operatoret, sepse kontrata është e dyshimtë. Vjosa, sa i përket inspektimeve në rrugën "Dardania", ende nuk ka përfunduar rregullimi i rrugës, ndërsa në rrugën "17 Shkurti", që nga pas lufta taksit qendrojnë aty, dhe asnjëherë nuk e keni ngritur si çështje, drejtori i inspeksionit do ta bëj një lokacion për ta. Për mbeturina është angazhuar ajo kompani me procedura të rregullta, ka marrë pjesë zyra e prokurimit, drejtoria e shërbimeve publike dhe është bërë zgjidhja më e mirë e mundur, pagesa do të bëhet e njejtë derisa të ndërmerren hapa të tjerë. Ali Ismaili, përmendi kampingjet, ka qenë kërkesë e AME-së, që shkollat e Fushë Kosovës, të përfshihen në kampingje dhe trajnime, nxënësit janë zgjedhur me vetëdëshirë, kujdestarët e klasave i kanë deleguar këta fëmijë, numri ka qenë i limituar, nxënësit do ta kryejnë këtë trajnim të gjithë brenda katër viteve sepse ajo qendër është ndërtuar për ta. Për ansambleistin Rrahim, do ta rregullojmë rrugën "Ymer Sfarqa". Për atë çka keni bërë ju z. Ali Topalli për Fushë-Kosovën, duhet të jeni në burg, për nënshkrimet tuaja për shpenzimin e buxhetit, vetëm katër ditë para fillimit

të mandatit të ri zgjedhor, ku puna e paraparë shtesë për realiuzim në teren, nuk është kryerë fare. Rruga "Dorentina", Etnik, ka probleme të pronave te lagjia e komuniteteve, dhe jemi duke e trajtuar mënyrën si të zgjidhet ajo së bashku me drejtorin. Rruga "Tahir Zemaj" do të rregullohet se do të krijohet qasja te Bau Market, për ansableistin Radoman për ujin në Kuzmin, do të pyesim ujësjellësin dhe për mbeturina KRM "Pastrimi" e ka në menagjim Kuzminin, ndërsa për deponi disa herë janë pastruar. Faleminderit.

Laureat Gojnovci replikë: Kryetar nëse dikush e ka vendin në burg, është ai që i ka bërë ata tenderë me ato kërkesa, i bëj thirrje prokurorisë nga ky Kuvend që ti hetoj ata tenderë, pse duhet të paguhet 23€ për ton kur ajo kompani ska shpenzime, kam hulumtuar në E – prokurim dhe afati nuk guxon të jetë për 21 ditë, dhe nuk duhet të largohen referencat ditën e nesërme për tenderë.

Kryetari i Komunës: Ajo kompani paguhet 23€, për shkak të bartjes të mbeturinave sepse nuk ka kamionë dhe duhet të paguhet vozitësi, ku i merr kompania kamionët nuk është çështje e imja, ajo paguhet për shërbimin.

Valon Murseli replikë: Kryetar unë e kritikova ish-pushtetin me pjesën e ndërtimeve, besoj që edhe ju pajtoheni, dua që kjo pjesë të rregullohet dhe të ketë standarde më të larta, unë përfaqësoj qytetarët, kam propozime, kërkesa, nuk kam vetëm kritika, nuk punoj për asnjë grup të caktuar, kemi përgjegjesi të kërkojmë llogaridhënie dhe të votojmë për, më të mirën e qytetarëve, faleminderit.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, po më vjen mirë që po takohemi prapë, u diskutuan shumë gjëra, ajo që më bëri përshtypje ishte asambleisti Migjen Kolshi, i cili tha se Vetëvendosje nuk ka kredibilitet me kritiku asnjë pushtet, unë për ty në kohën kur kam qenë asambleistë këtu, kam pas problem me kuptuar se a ke qenë asamblesit i LDK-së apo PDK-së, për shkak se ti ke qenë asambleist dhe familjaria e juaj e afërt ka qenë drejtoresh, ti atëherë ke pasur guxim ta kritikosh LDK-në, e pse unë nuk duhet ta kem atë guxim? Pati diskutim lidhur me kryeshefin e ndërmarrjes, procesi është në fazën e ankesave, përparësi kanë banorët e Fushë-Kosovës, nuk është problem nëse është i afërt i dikujt, sepse janë punësuar edhe më herët njerëzit që kanë qenë të afërm të dikujt si halla e dajë. Për pyetjen z. Murseli, besoj që drejtori do të ua japë përgjigjen me shkrim, objektet që janë duke u ndërtuar tash, janë me lejet që janë japur më herët, nuk e di saktë a kanë pasur kriter për elaborate të zjarrit, nëse nuk ka pasur duhet të shtohet. Sa i përket palestrës sportive, ajo është përfunduar sipas LDK-së, mirepo nuk ka energji elektrike, uji ka hyrë brenda gjatë kohës së reshjeve, prej menaxherit të kontratës jemi njoftuar se duhet të bëhen punë shtesë sepse as muret nuk kanë qenë të përfunduara dhe shumë punë të tjera, kontrata për punë shtesë është në vlerë 210,000.00€, të cilat kanë tentuar të vidhen në mënyrë klandestine nga ish drejtori i kulturës dhe ish drejtori i inspeksionit. Si ndiheni kur e keni proklamuar një palester sportive që nuk ka përfunduar ende?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pasi që u'a tërhoqi vërejtjen në vazhdimësi Shefit të grupit parlamentar të LDK-së, për respektim të procedurave dhe rregullave të Kuvendit, e lëshojnë sallën tetë asambleistë të LDK-së.

Nënkryetari i Komunës: Kryetari i federates së futbollit ka thënë se federate, stadium nuk ndërton dhe se memorandumin që e kanë pasur me komunën munden ta ndërprejnë kurdo që duan, ne kemi

mbetur me e ridestinu stadiumin me mjetet që kanë mbetur, edhe pse kompania deklaron se ka kryer punë atje, ky është veç një nga këto projekte që është bërë në këtë mënyrë sepse besoj që ka edhe shumë të tjerë. Përurimet janë bërë mirepo projektet nuk kanë përfunduar, faleminderit.

Migjen Kolshi: Unë jam në mandatin e katërt, asnjëherë nuk kam qenë bartës i listës por kam fituar me votat e qytetarëve. E përmende Mimozen, drejtoreshë të cilen e kam bashkëshorte të vëllaut, është nga Sllatina, nga një familje e cila kanë qenë në LDK gjithmonë, ajo e ka drejtimin e saj poltike e unë e kam timin, asnjëherë nuk kam tentuar ta pengoj orientimin e saj poltikë. Ka pas presion nga ju dhe i keni dhënë punë shtesë, sa i përket Migjenit, si asambleistë e din ti nënkryetar se me ty dhe me Durim Hajrën, i kemi ndalur drejtorët në sallë dhe i kemi penguar, dhe kur kryesuesi ka ngritur çështje ne kuvend e kam mbështetur gjithmonë, i ke procesverbalet te Hasani, se çka kam folur gjatë 12 viteve, nëse gjen diçka të jashtëligjshme që kam përkrahur, unë do jap përgjegjësi, unë thashë se nuk keni kredibilitet për shkak se i keni punësuar dy njerëzit kryesor të Burim Berishës, e kritikuat Ali Topallin, që ka qenë 2 vite drejtor ndërsa, Ekrem Berjanin e keni punësuar dhe ai ka qenë 16 vite drejtor, edhe Bardhyl Koiçiçin, i cili ka qenë shef i buxhetit e keni bërë drejtor dhe për atë arsye ju thashë që nuk keni kredibilitet, faleminderit.

Nënkryetari i Komunës: Unë nuk bëra akuzë të ulët, unë vetëm tu përgjigja që më akuzove që skam kredibilitet dhe ajo e afërme e jotja është bërë drejtoresh kur ti je bë asambleistë, te rasti ytë ka qenë i emëruar politikë e te rasti jonë e ka zgjedh komisioni. Nëse ju mendoni që Ekrem Berjani dhe Bardhyl Koçiçi kanë qenë personat kryesor të korrupsionit, nuk kemi çka të bisedojmë dhe menaxherët e kontratave nuk janë gjithmonë përgjegjës për mos përfundim të projekteve.

Migjen Kolshi: Asnjëherë nuk thashë që Ekrem Berjani dhe Bardhyl Koiçiçi janë kriminela, por është e vërtetë që kanë qenë njerëzit më të rëndësishëm të Burim Berishës.

Ali Ismaili: Portalet e juaja gjatë debatit këtu më dergojnë mesazhe me etiketime të ndryshme, unë i kam të vrarë dy të afërm që kanë qenë hoxhollar, i kanë shërbyer vendit për 30 vite, jemi ndër familjet e para në Fushë Kosovë që kemi ardhë prej Preshevës, kemi pasur pak tokë dhe për atë kemi marrë banesa, shtëpinë na kanë djegur serbët me ashkali, po ju tregoj që asnjëherë nuk ju lejoj të ma përlyeni dinjitetin e hoxhës, sepse nuk e kam ngatërruar asnjëherë me politikë. Kam një kërkesë a ka mundësi ky kuvend të nxjerrë një vendim dhe qytetarët të mos paguajnë taksë për mbeturina sepse ne si komunë po ua kryejmë atë shërbim dhe nëqoftëse dikush prej drejtorëve ka vjedhur ju lutem denonconi, nuk keni të drejtë ta denonconi një asambleistë i cili ka rolin vetëm të asambleistit.

Dardane Sogojeva Shala: Këtë replikë e kam me nënkryetarin, nëse LDK-ja më ka punësuar hallën mua, në vitet 99' LDK-ja, e ka larguar nga puna hallën time, dhe kur është hapur konkursi në QPS, ka aplikuar dhe është pranuar dhe sot po të them largoje nga puna sepse neve si familje nuk na intereson paga e saj, unë asnjëherë nuk e kam përkrahur LDK-në në kuvend, kam qenë kritikuesja më e madhe e tyre. Duhet të ju vie turp të përmendëni këso gjëra.

Drejtoresha e Shëndetësisë: Përshëndetje për të gjithë, çështja që e përmendi asambleisti i LDK-së, lidhur me ndalimin e lëshimit të certifikatave të punës, ju njoftoj se duke u bazuar ne Udhëzimin Administrativ me Nr.03/2024, për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore, certifikatat mjekësore nuk lëshohen në sistemin primar shëndetësor, kjo është kompetencë e nivelit tretësor,

komunat nuk kanë të drejtë ligjore të lëshojnë certifikaten e punës, kjo certifikatë lëshohet nga specialisti i mjekësisë së punës ose nga komisionet që formohet aty për aty në raste të vecanta varësisht prej insistitucioneve, personit ose punëdhënësit. Jemi konsultuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe na ka konfirmuar që nuk kemi të drejtë ta lëshojmë këtë certifikatë. Sa i përket pyetjes së z.Murseli, është me ligj e rregulluar që subvencionet ndahen, dhe ka disa kritere: Si të jetë banorë i Fushë Kosovës nga 3 ose 5 vite. Ndërsa mungesa e hemogramit, ne kur kemi ardhë e kemi gjetë një kontratë 3 vjecare për furnizim me material laboratorik, është shpenzuar materiali para se të mbaroj kontrata, furnitori është i papërgjegjshëm dhe ne jemi detyruar ta lidhim një kontratë të re 1 vjecare për ti mbuluar mungesat që i kemi në QKMF, faleminderit.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029, ftoj drejtorin për Buxhet dhe Financa të na paraqet përmbajtjen e materialit.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Përshëndetje për të gjithë, do të bëj shpalosjen e kornizës afatmesme buxhetore, të cilen ju e keni pranuar, planifikimi i buxhetit për vitet 2027-2029, ka filluar në muajin shkurt, ne i kemi dorëzuar të gjitha kërkesat tona për kategoritë ekonomike, në vecanti për të hyrat vetanake, pas kërkesës të dorëzuar në muajin shkurt është mbledhur komisioni i granteve, ku janë nëntë anëtarë, tre janë kryetar të komunave ndërsa të tjerët janë nga ministria. Me 15 Maj, ne kemi pranuar Qarkoren e Parë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku në bazë të kësaj Qarkore e kemi hartuar Qarkoren e Brendshme Buxhetore të cilën ja kemi shpërndarë drejtorëve të komunës, të shkollave, QKMF-së, etj. Këta kanë pasur kohë dy javë ta plotësojnë Qarkoren dhe ta dorëzojnë me 1 Qershor, te zyra e planifikimit të buxhetit. Në bazë të kësaj qarkore kemi hartuar kornizën afatmesme buxhetore të cilen sot ju e keni para jush. Tabela e parë përmbanë: shpërndarjen e granteve dhe te hyrave komunale, buxheti për vitin 2026, është 20,803,000.00€, buxheti për vitin 2027 është 29, 400,000.00€, kemi rritje të buxhetit prej 9,65%, kjo rritje ka ndodhur te granti i përgjithshëm me 1,193,000.00€, te granti i arsimit me 580,000.00€, te granti i shëndetësisë me 300,000.00€, dhe të hyrat vetanake janë rritur në 510,000.00€. Tabela tjetër është parashikimi i të hyrave komunale për vitin 2027-2029, të hyrat për vitin 2027 janë 4, 934,681.00€, është rritë për 11%, mbushës i të hyrave vetanake në komunën tonë janë: tatimi në pronë, lejet ndërtimore, mjedisore etj, ne si komunë rangohemi në vendin e shtatë për grumbullmin e të hyrave vetanake në nivel vendi. Tabela tjetër është: planifikimi i buxhetit për vitin 2027, nëpër kategori ekonomike, kemi stafin, paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione, transfere dhe investime kapitale. Paga dhe mëditje për vitin e ardhshëm janë të planifikuara 12,400,000.00€, mallëra dhe shërbime 3,500,000.00€, shpenzime komunale 550,000.00€, subvencione dhe transfere 2,422,000.00€, investime kapitale 10, 517,000.00€. Pagat dhe mëditjet marrin pjesë në buxhet me 42%, mallërat dhe shërbimet me 11.91%, shpenzimet komunale 1.87%, subvencionet 8.24%, investimet kapitale 35.79%, shpenzimet rrjedhëse marrin pjesë në shpenzim të buxhetit me 64. 21%, ne kemi kërkuar në vitin e ardhshëm në të gjitha programet vende të reja pune, në arsim 188,

shëndetësi 83 dhe administratë 44 vende pune. Investimet kapitale financohen prej dy burimeve: granteve dhe të hyrave vetanake, i kemi 48 projekte, 11 projekte janë në vazhdimësi, të gjitha projektet i keni para jush, ne si organizatë buxhetore kami planifikuar ti mbajmë 3 dëgjime publike për planifikim te buxhetit 2027-2029, ky është buxhet fillestar, gjatë dëgjimeve buxhetore investimet kapitale mund të ndryshojnë, por shuma jo. Faleminderit.

Kosovar Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para vetës kemi kornizën afatmesme buxhetore, do të doja të diskutoja për pjesën e implementimit të projekteve në të kaluarën të cilat edhe pse janë parashikuar në buxhet nuk janë përfunduar si duhet, si QMF 1, e cila nuk ka pranim teknik, gjithashtu dhe stadioni në Sllatinë, dhe ne zotohemi që projektet tona që i fusim në planifikim buxhetor, do të kryhen në nivelin më të mirë të mundshëm me të gjitha kushtet e nevojshme. Te projektet kapitale janë të parapara 48 projekte, infrastrukturë janë të parapara 11 projekte, në arsim 10 projekte, gjithashtu ka projekte në shërbime publike dhe shëndetësi duke përfshirë renovimin e QMF-ve dhe AMF-ve. 3 projekte me prioritet në komunën tonë janë: rregullimi i rrugës "Dardania", sheshi "Nëna Terezë" dhe Shtëpia e Kulturës në qytet e cila është në gjendje të mjerueshme, 33 projekte janë specifike, ndërsa 8 janë në disa lokalitete, 13 janë të trashëguara dhe këto janë bërë bazuar në kërkesat e qytetarëve, andaj ju ftoj ta votoni kornizën, faleminderit.

Migjen Kolshi: Zakonisht buxheti duhet të bëhet në atë mënyrë qe ti përshtatet ligjit, por njëkohësisht ti kthehet drejtëpërdrejtë qytetarëve, ata janë formuesit e këtij buxheti. Buxheti bëhet nga kryetari në bashkëpunim me anëtarët e kualicionit, unë me sa e pashë kornizën kryetari ka përfshirë pak projekte në krahasim sa ka premtuar në fushatë, ka qenë premtim i kryetarit që ngrohjen e qytetit ta bëj përmes KEK-ut, njëkohësisht ka nadrë 800,000.00€, për pompa termike, nëse në të ardhmen vjen ngrohja nga KEK a humbin këto mjete? Kampusi i shkollave të mesme mendoj që është shumë i nevojshëm për qytetin por keni ndarë vetëm 50,000.00€, dhe deri ne fund të mandatit janë diku 500,000.00€, të cilat janë për një shkollë dhe nuk besoj se mjaftojnë për kampus. Rruga rreth hekurudhës nuk është përfshirë në kornizë, 10,000.00€ i ka nadrë për shtëpinë e kulturës në Sllatinë, mirëpo komuna nuk ka te drejtë të nderhyj aty sepse është pronë e AKP-së, 50,000.00€ për shtëpinë e kulturës mendoj që nuk mjaftojnë. 350,000.00€ janë të ndara për zhavor, zhavorin Kosova e blen nga Serbia, te kultura ndërtimi i sallave të sportit në lagjen 28 dhe 29, të cilat janë të nevojshme por nuk besoj se ka pronë, renovimi dhe zgjerimi i stadiumit në Sllatinë të Madhe, ai stadimun nuk mund të renovmohet shkaku i pronës. Renovimi i objekteve shkollore "Bajram Curri", "Mihail Grameno" aneksi 2, "Daut Bogujevci", "Vëllëzërit Frashëri", "Zenel Salihu" dhe "Hivzi Sylejmani", unë kam kërkuar në senacën e parë të këtij viti me bartje të buxhetit të futet dhe shkolla e fshatit Harilac, për renovim sepse është shumë në gjendje të keqe. Digjitalizimi i objekteve shkollore mendoj që nuk është i nevojshëm, sepse në shkolla fëmijët nuk i kanë as kushtet elementare, ndërtimi i çerdheve në Sllatinë dhe Miradi e Epërme, shuma prej 200,000.00€, nuk besoj qe mjaftojnë dhe më bëri përshtypje ndërtimi i shtatorës së ish Presidentit Ibrahim Rugova, në vlerë 50,000.00€, gjë që as LDK-ja nuk e ka bërë, dhe unë kam kërkuar një fushë futbolli në fshatin Harilaç, ne si Parti Demokratike do të ju sjellim gjatë javës tjetër propozimet tona, në këtë mënyrë si është korniza ne nuk e përkrahim. Faleminderit.

Dashnim Bajrami: Përshëndetje për të gjithë, unë e kam lexuar kornizën buxhetore, ju falenderoj që e keni futur ndertimin e sallës sportive në lagjen tonë, vetëm te asfaltimi i rrugëve nuk janë emërtuar lagjia 28 dhe 29, deshta të di nga drejtori i infrastruktuës se a do të përfshihen këto lagje? Faleminderit.

Valon Murseli: Në këtë kornizë mendoj së është dashur të futet ndërtimi i një shkolle në qytet në mënyrë që të lirohet aneksi 1 dhe 3, nëse mund të gjendet një lokacion rreth Elizës, shujta ditore për nxënës e cila ka qenë premtim elektoral nuk është pjese e këtij dokumenti, partneriteti me kopshte private për subvencionim të pagesës për fëmijë, të paktën të fillohet me 50/50%, themelimi i fondit komunal për zhvillim profesional të mësimdhënësve, projekti për ngrohje qendrore nga KEKU, ska mjete për pjesën e studimit të fizibilitetit, rruga "Fehmi Lladrovci" dhe "Dorentina", shpresoj që nëse nuk kryhet nga niveli qendror të merret një vendim në kuvendin komunal, parkingjet me kate, parkingjet nëntokësore, trafiku urban që është premtuar, blerja dhe subvencionimi i autobusëve ekologjik, qendrat rinore ne çdo lagje, krijimi i nje fondi për bujqësi, kerkoj që për pjesën e bujqësisë të rritet buxheti, kalimi i 2 hektarëve tokë për varreza të qytetit dhe kompletimi me infrastrukturë përcjellëse, gjë që më ra në sy është rritja e stafit të kryetarit nga 22 në 27, doja të dija pse është kjo rritje? Vendosja e ashensorëve në lagjen "Apollonia", marrja me qera e lokaleve që i përmbushin standardet për çerdhe, investimi ne rrugën "Salih Puqolli" dhe lidhja e saj me rrugën kryesore, investimi në kanalizim ne rrugën "Nënë Tereza", rritja e buxhetit për kënde të lojrave në qytet, sidomos te parku i pishave në Sllatinë, ndërtimi i fushave të reja sportive sidomos në qytet, rritja e buxhetit për transport të nxënësve në qytet, mbështetje në bujqesi duke subvencionuar rasadin, folien e zeze, farat, plehëra, etj, në sektorin e mishit mbështetje për ferma, në Vragoli, është bërë pastrimi i fushës në adresën Ramnisht, ku kërkohet nga qytetarët që të ketë drunjë, vendosje të ulseve dhe të përdoret si park, faleminderit.

Rrahim Tërrnava: Mendoj që edhe pse nuk kemi buxhet të mjaftueshëm është mirë të nënshkruhen projekte të mëdha, për shkak se mund të lehtësohen shumë gjëra në komunë, komuna mundet me kohë ti paguaj ato projekte dhe të zhvillohet, dhe mendoj që duhet të formohet komisioni për të mbikqyrë secilën kontratë dhe çdo kërkesë e asambleistëve të merret seriozisht. Faleminderit.

Driton Ademi: E degjuam elaborimin e drejtorit, është mirë të ruhet kontuniteti i propozimeve sepse në shtator e kemi buxhetin për 2027, dhe atëherë i specifikojmë propozimet tona lidhur me mjetet, po shpresoj që ky buxhet i përfshinë drejtoritë dhe prioritetet e tyre, premtimet e kryetarit dhe kërkesat e qytetarëve, faleminderit.

Suhat Ademi: Kërkoj nga drejtori dhe nga ju të ceket çdo gjë që përfshinë lagjen 28 dhe 29, sepse në të kaluarën nuk është shënuar asgjë për ato lagje dhe nuk është bërë asgjë. Te infrastruktura nuk është përfshirë askund lagjia 28 dhe 29, dhe mendoj qe duhet të përfshihen sepse kanë nevojë, andaj ju lusë të përfshihen këto lagje specifikisht. Faleminderit.

Migjen Kolshi: Kam një pyetje për drejtorin, sot e kemi rregulloren për tarifa dhe taksa, pse nuk i ke paraparë të hyrat nga taksat në buxhet dhe shkolla në fshatin Lismir i keni paraparë rreth 200,000.00€, kur ky kuvend e ka anuluar një vendim që e ka pasur donacion një shkollë nga Bashkësia Islame?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pasi diskutime të tjera nuk ka po e qesim në votim propozimin;

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029" dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2027 – 2029, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor në shumën e mjeteve financiare si vijon:

1.1 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 29,389,877.00€;
1.2 Për vitin 2028 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 30,933,678.00€
1.3 Për vitin 2029 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 32,735,875.00€.

Pika e katërt (4) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim "Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026" materialin e keni para vetës, e hapi diskutimin.

Migjen Kolshi: Ne si Parti Demokratike nuk e përkrahim këtë propozim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk kemi diskutime tjera e qesim në votim propozimin.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026" dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim-plotësimin e Vendimit Nr. 145, të datës 04.05.2026, lidhur me ridestinimin e mjeteve financiare për buxhetin e pa shpenzuar të vitit 2025, për shpenzim në vitin 2026, në shumë të përgjithshme prej: 15,000.00€, nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve prej kodeve të nën programeve si vijon:

1.1 Zyra e Kryetarit të Komunës - kodi i nën-programit Nr. 16002, shuma e mjeteve financiare prej: 9,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162;
1.2 Integrime Evropiane kodi i nën-programit Nr. 16542, shuma e mjeteve financiare prej: 2,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162 dhe

1.3 Shërbimet Sociale kodi i nën-programit Nr. 75506, shuma e mjeteve financiare prej: 4,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162.

2. Mjetet financiare të bartura për shpenzim në vitin 2026 në kategorinë ekonomike mallra e shërbime, të evidentuara në paragrafin një, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, shpenzohen për pagesat e obligimeve financiare - faturave të vitit 2026, sipas kontratave kornizë.

Pika e pestë (5) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim "Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese" diskutimin për këtë pikë e kemi pasur në seancën e kaluar, nuk ka ndryshuar asgjë, nëse nuk ka diskutime po e qesim në votim propozimin.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese" dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 743, të datës 15.05.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit 'Hospica', në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00706-13, në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, me sipërfaqe S=50000m2, e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 30.06.2026, me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përfshirjen e saj, në dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë – Kosovës për vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim "Propozimin për shpalljen e titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Fushë – Kosovës për vitin 2026" po e hapim diskutimin.

Kosovar Ademi: E mbështesim këtë propozim.

Migjen Kolshi: Emri i Gani Bajramit, ka qenë i propozuar edhe në mandatin e kaluar, qeverisja e kaluar nuk e ka përkrahur, ne e përkrahim dhe mendoj se në të ardhmen duhet të shpallen qytetar nderi dhe luftëtarët.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: meqenëse nuk ka diskutime tjera, po e qesim në votim propozimin.

U votua me unanimitet nga anetarët e pranishëm në mbledhje

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për shpalljen e titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë - Kosovës për vitin 2026" dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e 'Propozimit për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' të Komunës së Fushë – Kosovës për vitin 2026', për personalitetin e shquar **z. Gani Shaban Bajrami**, i lindur me datën 13.09.1953, me vendbanim në Fushë-Kosovës, me motivacionin për dhënien e kontributit të jashtëzakonshëm, jetësor në fushën e informimit dhe gazetarisë,

profesionalizimin e treguar si gazetar, komentator dhe redactor, si dhe për pasqyrimin me dinjitet e përkushtim të ngajrjeve shoqërore në Komunën e Fushë-Kosovës dhe më gjerë.

2. Titulli dhe dekorata përkatëse do t'i dorëzohen personalisht të nderuarit Gani Shaban Bajrami në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Komuna e Fushë-Kosovës.

Pika e shtatë (7) - Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi post mortem", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim "Propozimin për shpalljen e titullit "Qytetar nderi post mortem", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026", meqenëse nuk ka diskutime po e qesim në votim propozimin.

U votua me unanimitet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për shpalljen e titullit "Qytetar nderi post mortem", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026" dhe mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e titullit për nderimin e të ndjerit Fazli Haziri i lindur me datën 20.05.1957 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026, veprimtarit dhe personalitet të shquar me kontributin e tij, në shërbim të qytetarëve të komunës tonë, në fushën e kulturës, bibliotekave, artit, shumë shfaqjeve në teatrin amator 'Qëndresa' të Fushë-Kosovës.
2. Titulli dhe dekorata përkatëse do t'i dorëzohen familjes së të ndjerit, në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Komuna e Fushë-Kosovës.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për Shqyrtim të dytë Projekt-Rregulloren për taksa komunale, po e hapi diskutimin:

Kosovar Ademi: Pas analizimit të rregullores, te pika 1.104, autoserviset, automekanikët, dhe elektricistët janë të ndara me një kategori, pastaj ndahen secila në kategori të ndryshme, ne propozojmë që të vazhdojnë të mbesin në një kategori dhe te ordinanca mjekësore private, ordinanca ofron një kategori të shërbimeve ndërsa klinka ka disa kategori të shërbimeve dhe konsideroj që nuk është në përputhje tarifa mes tyre, dhe kërkoj që të ulet tarifa për ordinance, nuk kemi dicka tjetër dhe e përkrahim.

Migjen Kolshi: Unë kam qenë pjesë e grupit punues të kësaj rregulloreje, ne kemi dhënë propozime, ide dhe asnjëra nuk është futur, ne si Parti Demokratike jemi kundër taksave për bizneset në komunën e Fushë – Kosovës, e kemi pasur premtim elektoral dhe do ta mbajmë.

Driton Ademi: Në të gjitha rregulloret ka një lloj byrokracie, te zyra ligjore ka disa vendime që duhet respektuar sepse kryerja e një shërbimi nga komuna për qytetarët nuk mund të kushtëzohet më një dokument tjetër, shiqoni vendimet që të mos biem ndesh më disa vendime ekzistuese, keni kujdes të zvoglimi i barrës administrative, te kriteret e pagesave, dhe do i përkrahim të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse nuk ka diskutime tjera, po e qesim në votim propozimin.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Shqyrtimin e dytë të Projekt-Rregullores për taksa komunale" dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e 'Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të taksave komunale vjetore për subjektet afariste, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtimi të dytë Projekt-Rregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike, nëse nuk ka diskutime po e qesim në votim.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota "për", një "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike" dhe mori:

VENDIM

1. Për miratimin e 'Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të shfrytëzimit të hapësirave publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës: E kemi për shqyrtim Projekt - Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës, nëse nuk ka diskutime e qesim në votim.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës" dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e 'Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.

2. Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të ndarjes së subvencioneve nga komuna.
3. Pjesë përbërëse e ketij vendimi është Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Projekt – Rregulloren për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, meqenëse nuk ka diskutime po e qesim ne votim.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës" dhe mori:

VENDIM

1. Për miratimin e 'Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe organizimit të lagjeve urbane në qytet dhe fshatrave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e ketij vendimi është Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për shqyrtim dhe dhëniën e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi propozimin që ka ardhë nga Partia Demokratike, të cilët kanë kërkuar ndihmë financiare për shërim për palën Safet Selimi, propozojë qe ne të marrim një vendim që te delegojmë këtë kompetencë, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe komisionit që është marrë me vlerësimin e problemeve shëndetësore, sepse Kuvendi Komunal duhet ti rregulloj gjerat por jo në këtë formë, kerkojë mirekuptimin tuaj.

Valon Murseli: Është e vërtetë që ky propozim ka ardhë nga Partia Demokratike, për mbështetje të veteranit të UÇK-së, i cili ka më shumë se një vit që po trajtohet, ka bërë një ndërhyrje në zemër, ka nevoje për transplant të veshkës dhe kjo mund të zgjas gjatë, kërkesa për mbështetje është në vlerë 5000€, kërkoj të hedhet në votim dhe të mbështetet, nëse ka raste tjera unë personalisht dhe besoj të gjithë të tjerët do ta përkrahim. Vlera që kërkojmë është minimale në krahasim me nevojat e tij.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne përulemi para çdo luftëtari, mirepo raste të tilla duhet ti delegojmë Drejtorisë së Shëndetësisë, ti obligojmë që me këtë rast të merren specifikisht, po e qesim në votim që ky rast ti delegohet Drejtorisë së Shëndetësisë, kush është "Për"

U votua me unanimitet nga anëtarët të pranishmit në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozimin për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës për ndihmë financiare për shërim palës Safet Selimi", dhe mori:

V E N D I M

1. Për shqyrtimin urgjent të kërkesës së palës Safet Selimi, për ndihmë financiare për shërim të mëtutjeshëm në një Komisionin urgjent të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Kuvendi i Komunës i kërkon Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të marrë një vendim në përputhje me mundësitë buxhetore të mjeteve financiare nga kategoria ekonomike për ndarjen e subvencioneve, për të ndihmuar palën Safet Selimi, për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve të trajtimit të tij shëndetësor.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet një Komisioni urgjent të shëndetësisë, duke respektuar aspektet e mirëqenies sociale, në përputhje me nenin 17, shkronja (k), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për plotësimin e vendimit në përfshirjen e drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi propozimin për përfshirjen e drejtorit të Inspeksionit Durim Hajra, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, meqenëse nuk ka diskutime po e qesim në votim.
U votua me unanimitet nga anëtarët të pranishmit në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi "Propozim për plotësimin e vendimit në përfshirjen e drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029" dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 2, në të cilin shtohet nën-paragrafit 2.23, pjesë përbërse e vendimit Nr. 76, të datës 24.02.2026, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029, me anëtarin e ri z. Durim Hajra - Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për kryerjen e detyrave dhe punëve të caktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe për punën e tij e informon Kuvendin e Komunës.

Pika e katërmbëdhjetë (14) - Të ndryshme.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala është për ju asambleistë.

Migjen Kolshi: Propozojë të plotësohet Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra, me anëtaren tonë znj. Aida Alimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës, kush është "për"

U votua me unanimitet nga anëtarët e pranishmit në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve e aprovoi "Ndyshim - plotësimin e vendimit Nr.74, të datës 24.02.2026" dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 74, të dates 24.02.2026, për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra me anëtarën e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi - përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 74, të datës 24.02.2026, për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 10, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëqoftëse nuk ka dikush tjetër të shtojë dicka, konstatojë se është mbyllur mbledhja.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 13:30 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani